

STATUTI

I Shoqërise me përgjegjësi të kufizuar “ATA-STUDIO”

Personat që firmosin si me poshte:

- Ardian ILIA, lindur me datë 07.09.1970, në Fier, Shqiperi dhe banues ne Tiranë, mbajttese i ID me numer personal H00901027R.
- Artur BRAHAJ, lindur me date 27.09.1970, ne Shkoder, Shqiperi dhe banues ne Tirane, mbajtes i ID me numer personal H05927102U

Ne baze te Ligjit nr 9901, date 14.04.2008 “ Për Tregëtarët dhe Shoqërite Tregëtare “, krijojne Statutin e Shoqërise.

KREU 1

Themelimi, Forma, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia.

Neni 1

Data e Themelimit, Forma, dhe Themeluesit.

- (1) Sot me date – 1 Shkurt 2019, ne themeluesit, kemi vendosur, te krijojme nje shoqeri me përgjegjësi te kufizuar, ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi, sipa Ligjit nr 9901, date 14.04.2008 “ Për Tregëtarët dhe Shoqërite Tregëtare “, dhe aktet e tjera nenligjore qe jane ne fuqi. Shoqëria eshte nje person juridik Shqiptar, i cili do te ushtroje aktivitetin privat ne Territorin e Republikës se Shqiperise, pas regjistrimit ne QKB.
- (2) Themelues te Shoqërise janë;
 - Ardian ILIA, me ID H00901027R, atësia Kristo, i datëlindjes 07.09.1970, me adrese Nj. Bashkiake nr 2, Tiranë
 - Artur BRAHAJ, me ID H05927102U, atësia NEBI, i datëlindjes 27.09.1970, me adrese Nj. Bashkiake nr 5, Tiranë

Neni 2


Emërtimi

Emri I Shoqërise është “ATA-STUDIO” shpk

Neni 3

Objekti

Ushtrimi i aktivitetit si kontabel i miratuar, mbajtja e kontabilitetit dhe konsulence financiare e juridike për të trete, ushtrimi i auditimeve ne subjekte publike dhe jo publike dhe konsulence ne marrëdhëniet me bankat.



Neni 4 Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e Shoqërisë, do të jetë e pakufizuar. Ajo mund të shpërbehet në çdo kohë me vendim të asamblesë së Ortakëve

Neni 5 Selia

- (1) Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën; Rruga "Sabri Preveza", Pallati Gu AI, Kati Perdhes, Unazë e Re, Tirane.
- (2) Adresa e faqes zyrtare të Internetit është: studiokontab.ata@yahoo.com
- (3) Adresa e Shoqërisë, për qëllime komunikimi elektronik është si vijon Studiokontab.ata@yahoo.com

Neni 6

Shoqëria ka Vullen e Saj ku janë të percaktuara inicialet e emertimit të saj, NIPT-i dhe adresa baze.

KREU II Kapitali

Neni 7

Kapitali Themeltar

Kapitali fillestar, njëkohësisht dhe Kapitali Themeltar i Shoqërisë është; 300 000 (tre qindmijë) leke, i ndarë në dy kuota me vlerë nominale përkatësisht, 150 000 leke njëra kuota dhe 150 000 leke kuota tjetër.

Kapitali Themeltar përbehet nga Kontribute në vlerë monetare shuma 300 000 leke.

Neni 8

Pjesëmarrja e Themeluesve në Kapitalin Themeltar të Shoqërisë është në përputhje me kontributet e mëposhtme;

- Ortaku themelues Ardian ILIA, zotëruar i 1 (një) kuota me vlerë të përgjithshme; 150 000 leke, që përbën 50 % të Kapitalit Themeltar të Shoqërisë.
- Ortaku Themelues Artur BRAHAJ, zotëruar i 1 (një) kuota me vlerë të përgjithshme; 150 000 leke, që përbën 50 % të Kapitalit Themeltar të Shoqërisë.

Neni 9

Zmadhimi dhe zvogelimi i Kapitalit.

Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të Kapitalit Themeltar për kontributet në para dhe kontributet në natyrë, gjë e cila arrihet nëpërmjet



emerimit ne rruge ligjore te nje eksperti te autorizuar, per keto kontribute sipas kerkeses se paraqitur nga nje person I autorizuar nga te gjithë ortaket.
Ne asnje rast, shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin e Shoqërise.

Zvogelimi I Kapitalit, lejohet nga Asambleja e Ortakeve, e cila merr vendime ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e Statutit.

Në të gjitha rastet, zvogëlimi i prek ortaket në të njëjtën masë ndaj pjeseve të kapitalit që përfaqesojne.

Neni 10

Transferimi I Kapitalit

Kuotat e Kapitalit ne nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar, si dhe te drejtat që rrjedhin prej tyre mund te fitohen, apo kalohen nëpërmjet;

- a. Kontributit ne kapitalin e Shoqerise
- b. Shitblerjes
- c. Trashëgimisë
- d. Dhurimit
- e. Çdo menyre tjeter e parashikuar me ligj.

Pjeset e kapitalit themeltar, jane lirisht te transferueshme ndërmjet ortakëve, per sa nuk parashikohet ndryshe ne Statut.

Pjeset e Kapitalit Themeltar jane lirisht te transferueshme ne rruge trashëgimie.

KREU III

Organet vendimarrëse dhe drejtuese

Neni 11

Organet Vendimarrëse

Asambleja e Ortakeve, është organi i vetëm vendimarrës i Shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve, është organi i vetem vendimarrës i Shoqërisë që miraton çdo ndryshim te Statutit, sipas modaliteteve te pëcaktuara me ligj.

Asambleja e pergjithshme e ortakeve është përgjegjese për marrjen e vendimeve për Shoqërine per çeshtjet e mëposhtme;

- Përcaktimin e politikave tregtare te Shoqerise.
- Ndryshimet e Statutit.
- Emërimin dhe shkarkimin e Administratoreve.
- Emërimin dhe shkarkimin e likujduesve dhe Eksperteve Kontabel te Autorizuar.
- Përcaktimin e shperblimeve per Administratoret, Likujduesit dhe Ekspertet Kontabel te Autorizuar.
- Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire edhe paraqitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve per ecurine e veprimtarise.
- Miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
- Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit.
- Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre.



- Perfaqesimin e Shoqerise ne Gjykata te te gjitha niveleve si dhe ne procedimet e tjera ndaj Administratoreve
- Perfaqesimin e shoqerise ne marredheniet me Organet e Qeverisjes Qendrore dhe Lokale.
- Riorganizimin dhe prishjen e Shoqerise.
- Miratimin e rregullave procediriale per thirrjen dhe zhvillimin e Mbledhjeve te Asamblese se Ortakeve.
- Çështje te tjera te parashikuara nga ligji apo nga Statuti.

Nje Ortak mund të perfaqesohet ne Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve, ne baze te nje autorizimi, nga nje Ortak Tjeter, apo nje person i tretë.

Administratori I Shoqerise (ne rastin kur nuk eshte Ortak), nuk mund te veproje si perfaqesues I ortakeve ne Asamblene e Përgjithshme.

Autorizimi I përfaqesimit mund te jepet vetem per nje mbledhje asambleje te pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

Neni 12

Menyra e thirrjes se Mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve

- (1) Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet njoftimit me shkrese ose, nëse parashikohet nga Statuti, me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese, apo me mesazh elektronik duhet te permbaje; vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites. Ky njoftim duhet t'u dergohet te gjithë ortakeve jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.
- (2) Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas pikes 1 te këtij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithë ortaket jane dakort, për te marre vendime pavarsisht parregullsisë.

Neni 13

Kuorumi

- (1) Në rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 (tridhete) per qind te kuotave.
- (2) Ne rastin kur Asambleja e Pergjithshme duhet te vendose per çështje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87, te ligjit " Per tregetaret dhe Shoqerite tregetare ", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numerit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese,apo mjete elektronike,sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.
- (3) Nese Asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuoromit te permendur me lart,asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite,me te njejtin rend dite.



Neni 14 **Marrja e vendimeve**

Asambleja e pergjitheshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise. Asambleja e pergjitheshme vendos me shumicene votave te ortakeve pjesemarres, per ceshtje te tjera si:

- a) Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise,
 - b) Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve,
 - c) Emerimin e shkarkimin e likujdvesve dhe te experteve kontabel te autorizuar,
 - d) Percaktimin e shperblimeve,
 - e) Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire paraqitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise,
 - f) Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve,
 - g) Miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese,
- Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet ne QKB duke pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 15 **Përfashtimi nga e drejta e votes**

1. Ortaku nuk mund te ushtroje të drejten e votes nëse asambleja e pergjithshme merr vendim per:
 - a) Vleresimin e vperimtarise se tij,
 - b) Shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij,
 - c) Ngritjen e nje padije ndaj tij nga shoqeria,
 - d) Dhenjen ose jo te perfitimeve te reja.
2. Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues I autorizuar, I autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi, ashtu si edhe ortaku qe perfaqeson.

Neni 16 **Administrimi**

- (1) Asambleja e pergjithshme emeron nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati I emerimit eshte 5 vjet, me te drejte ripertesitje. Emerimi I administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.
- (2) Administratoret e nje shoqerie tregtare meme, sipas percaktimit te nenit 207 te ketij ligji, nuk mund te emerohen si administratore te nje shoqerie te kontrolluar anasjelltas. Cdo emerim I bere ne kundërshtim me keto dispozita eshte I pavlefshem.
- (3) Personat e meposhtem caktohen si Administratore te pare te shoqerise deri ne emerimin e tyre nga mbledhja e pare e Asamblese se pergjithshme.



Te dhenat e identifikimit:
(mbiemrat, emrat, adresat)

dhe specifikimet e nenshkrimit:

Ardian ILIA me ID H00901027R

Atesia; KRISTO,
Datelindja: 07.09.1970, me adrese Nj. Bashkiake nr 2, Tirane.

Neni 17 **Kompetencat e Administratoreve**

Administratoret kane te drejte dhe detyrohen të:

- a) Kryejne te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te Shoqërise, doke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga Asambleja e Pergjithshme.
- b) Përfaqesojne Shoqerine tregtare.
- c) Kujdesen për mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te Shoqerise.
- d) Përgatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, I paraqesin keto dokumente perpara Asamblese se pergjithshme per miratim.
- e) Krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, që kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e Shoqerise.
- f) Kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te Shoqerise, siç parashikohet ne Ligjin per Qëndren Kombetare te Regjistrimit.
- g) Raportojne perpara asamblese se Pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te veçante per veprimtarine e Shoqerise tregtare.
- h) Kryejne detyra te tjera te percaktuara me ligj dhe me statut.

Administratoret jane te detyruar te therrasin Asamblene e Pergjithshme ne rastet kur:

- Sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e Shoqerise nuk I mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.
- Shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive , te cilat kane nje vlere me te larte se 10 % te aseteve te Shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te çertifikuara.
- Shoqeria brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak, pasuri qe kane vlere me te larte se 10 % te aseteve te Shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te çertifikuara.

Nese Asambleja e Pergjithshme emeron me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkerisht shoqerine.

Asambleja e Pergjithshme, mund te shkurtoje administratorin, ne çdo kohe me shumice te zakonshme. Padite qe lidhen me shperblimin e Administratorit, ne baze te marrëdhënieve kontraktore te punes, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne Fuqi.

Neni 18 Pergjegjesia e e administratorit

Administratori eshte pergjegjes individualisht, ndaj Shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit apo per faje te te kryera gjate administrimit te Shoqerise.

Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga Asambleja, qe I sjellin dem Shoqerise, i ngarkohen administratorit dhe Ortakut qe ka bere marreveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat ekonomike perkatese.

1. Përveç sa është parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 17 dhe 18 te ligjit " Per Tregëtarët dhe Shoqerite Tregtare ", administratori detyrohet;
 - a. Te kryeje detyrat e tij te percaktuara me ligj dhe ne statut, me mirebesim e ne interesin me te mire te Shoqerise ne teresi, duke I kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis.
 - b. Te ushtroje kompetencat qe I njohen me ligj dhe me Statut, vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita.
 - c. Të vleresoje me pergjegjesi çështjet per të cilat merret vendim.
 - d. Te parandalpje dhe menjanoje rastet e konfliktit , prezent, apo te mundshem, te interesave personale me ato te Shoqërise.
 - e. Te ushtroje detyrat e tij me profesionalizem dhe kujdesin e nevojshem.
2. Administratori, gjate kryerjes se detyrave te tij, pergjigjet ndaj Shoqerise per çdo veprim apo mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e Shoqerise Tregtare, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi eshte kryer me mirebesim.
3. Nese, Administratori vepron ne kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale sipas pikave 1 dhe 2 te ketij neni, eshte I detyruar t'i demshperbleje Shoqerise demet qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje çdo fitim personal, qe ata apo, personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te rregullt, e sipas standarteve te kerkuara. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator, ata pergjigjen ndaj Shoqerise ne menyre solidare.
4. Në mënyre te veçante, por pa u kufizuar ne to, administratori eshte I detyruar t'i demshperbleje Shoqerise demet e shkaktuara nese, ne kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr 9901, date 14.04.2008 " Për Tregëtarët dhe Shoqerite Tregëtare ", kryen veprimet e meposhtme:
 - U kthen ortakeve kontributet
 - U paguan ortakeve interesa apo dividente
 - U shperndan aktivet e Shoqerise
 - Lejon qe Shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare kur ne baze te gjendjes financiare, duhet te parashikohej qe Shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet.
 - Jep kredi.



Përveç padise për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit,ortaket individualisht ose se bashku,kane te drejte te ngrene padi penale kunder administratorit.

Paditesit kane te drejte te njekin ne rruge ligjore shlyerjen e plote te demit qe I eshte shkaktuar shoqerise perfshire edhe demshperblimin financiar,nese eshte e nevojshme.Asnje vendim I asamblese nuk mund te pengoje ngritjen e kerkese padise kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

KREU IV

Viti financiar – ekspertet

Neni 19

Viti financiar

Viti financiar i shoqërise filln me 1 janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.Perjashtimisht,viti I pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 20

Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithë dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise,ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille I ngarkuar nga ana e ortakeve.

Në perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe ate per kotrollet periodike te ushtruara,te cilat eshte I detyruar qe tja paraqese e dorezoje ne kohe reale ortakeve per ti shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

Neni 21

Prishja dhe likujdimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe:

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj,
- b) me vendim te Asamblese se Ortakeve,
- c) me hapjen e proceduarave te falimentimit,
- d) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi I veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723,date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit"
- e) me vendim te gjykates.

Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilen parashikojne menyren e likujdimit te shoqerise,duke caktuar 1 apo disa likujdatore dhe shenuar ne cdo dokument prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese "Shoqeri ne likujdim e siper".Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likujdimit ne gjendjen e aftesise paguese,me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

Likujdimi kryhet nga likujduesit e emeruar nga ortaket.

Nese ortaketr nuk marrin nje vendim per emerimin e likujdvesve,brenda 20 diteve kalendarike, pas prishjes,cdo person i interesuar mund ti drejtohet gjykates,per te caktuar nje likuidues.

Neni 22

Riorganizimi i shoqerise bashkimi-ndarja

Shoqëria mund te ndahet,bashkohet sipas vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve,ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne pjesen IX te Ligjit 9901 date 14.04.2012 "per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare"

Neni 23

Baza Ligjore

Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statutdhe dispozitat e legjislacionit shqipetar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut do te bazohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare",Kodi Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqipërisë.

Neni 24


Mosmarreveshjet

Për mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti,si dhe per vdo mosmarreveshje qe mund te linde mes Shoqerise dhe te treteve,do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

**ORTAKËT
E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

"ATA-STUDIO" Sh.p.k

**ORTAKU
Ardian ILIA**



**ORTAKU
Artur BRAHAJ**

